

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 1

Me këtë rregullore krijohet baza ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Mamushës (më poshtë: Komunë).

Neni 2

Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit në Komunë.

Neni 3

Organet komunale marrin pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit, në bazë të autorizimeve dhe detyrave të dala nga dispozitat ligjore dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Komuna është përgjegjëse për këto çështje që kanë të bëjnë me mjedisin:

a/ Krijimin e standardeve në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit (më poshtë i quajtur: Ligji), të akteve tjera të nxjerra në bazë të Ligjit dhe kësaj rregulloreje për operatorët lokalë, të shërbimeve publike, në fushën e mbrojtjes së mjedisit ;

b/ Sigurimin e veprimit të operatorëve sipas këtyre standardeve;

c/ Aprovimin e planeve dhe programeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit për territorin e Komunës;

d/ Krijimin e masave të arsyeshme për mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë që të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, në pajtim me Ligjin, aktet tjera të nxjerra në pajtim me Ligjin dhe më këtë rregullore;

e/ Krijimin dhe fuqizimin e masave që kanë për qëllim kontrollimin e nivelit të zhurmës në territorin e komunës;

f/ Mbjaj shënime të cilat përfshijnë të dhënat për të gjitha aktivitetet, aplikimet për leje mjedisore komunale, licenca dhe autorizime tjera mjedisore;

g/ Siguron qasje të pa pengueshme për qytetarët në informata mjedisore dhe të mundësojnë pjesëmarrjen e publikut;

i/ Çështjet tjera që kanë të bëjnë me mjedisin, e që dalin nga Ligji dhe dispozitat tjera plotësuese të nxjerra në pajtim me Ligjin.

Neni 5

Objektivat kryesorë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Komunë, janë:

a/ Zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe dëmit ndaj mjedisit, dhe zvogëlimi ose ndalimi i atyre aktivitetëve ekonomike dhe aktivitetëve të tjera që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;

b/ Mbrojtja e balancës së përgjithshme ekologjike në territorin e komunës;

c/ Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës bujqësore;

d/ Mbrojtja e peizazheve të vlefshme natyrore; dhe

e/ - Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit.

Neni 6

6.1. Të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit, standardet dhe aktivitetet do të projektohen dhe implementohen në mënyrë që:

- të balancohen objektivat e mbrojtjes së mjedisit me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës, dhe
- të zvogëlohen shpenzimet në nivel të arsyeshëm, që të mund të përballohen nga qytetarët e Komunës.

6.2. Individëve, ndërmarrjeve, organeve dhe organizatave tjera iu ndalohen aktivitetet, me të cilat në mënyrë të paarsyeshme i rrezikojnë peizazhet dhe lokalitetet nën mbrojtje në territorin e Komunës.

6.3. Organet dhe organizatat tjera komunale, do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet për zhvillimin dhe përvetësimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Neni 7

7.1. Drejtoria kompetente, në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe aktet tjera të nxjerra në bazë të tij, do të hartojë Programin Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit dhe programe pune të ngjashme.

7.2. Programin, nga paragrafi paraprak, e miraton Kuvendi i Komunës së Mamushës.

Neni 8

8.1. Drejtoria kompetente, harton Planin hapësinor të komunës, Planin për menaxhimin e resurseve natyrore dhe planet e programet e zhvillimit, të përcaktuara me ligj, të cilat kanë ndikim në mjedisin, e të cilat patjetër duhet të përfshijnë vlerësimin e aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimin e tyre në mjedisin.

8.2. Planifikimi hapësinor dhe logjistik-urban, do të :

a/ - përshkruajë masat për mbrojtjen e natyrës, lokaliteteve nën mbrojtje, ujit, tokës, hapësirave të gjelbëruara publike dhe zonave rekreative,

b/ - definojë rrezikun për mjedisin nga lokacionet e ndotura, lokacionet e rrezikuara nga erozioni, nga hedhja e materialeve të papërpunuara dhe të definojë propozimin e masave për rehabilitimin e lokacioneve të tilla,

c/ - përcaktojë masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit për hapësirat e dedikuara për përdorimin e burimeve natyrore, ndërtimin e fabrikave industriale dhe ndërtimin e strukturave për përqendrimin e mbeturinave.

8.3. Vlerësimi i aktiviteteve të planifikuara përfshinë analizimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit, ndikimin e mundshëm të aktiviteteve të planifikuara në mjedis, veprimet për zbutjen e tij, si dhe zhvillimin ekonomik.

8.4. Të gjitha planet nga paragrafi 1 i këtij neni miratohen nga Kuvendi i Komunës së Mamushës.

Neni 9

Drejtoria kompetente, në bashkëpunim me organet tjera komunale i paraqet Kuvendit raport dyvjeçar për gjendjen e mjedisit.

Raporti përveç tjerash përfshinë të dhëna për:

a/ - gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis,

b/ - ndikimin e mjedisit në shëndetin e popullatës në komunë,
c/ - dëmet ndaj mjedisit;
d/ - qëndrueshmërinë e përdorimit të burimeve natyrore;
e/ - implementimin e programit për mbrojtjen e mjedisit në komunë dhe programet e punës, si dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
f/ - marrjen e masave për mbrojtjen e natyrës, sukseset nga masat e marra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
g/ - analizat për funksionimin e Drejtorisë kompetente dhe organeve tjera, dhe veprimtaritë e operatorëve që ofrojnë shërbime publike në funksion të mbrojtjes së mjedisit,
h/ - vlerësimin e shpenzimeve në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen për ndikimin ekonomik në aktivitetet që kanë të bëjnë me mjedisin, të bëra nga Drejtoria kompetente.

Neni 10

Drejtoria kompetente, në përputhje me aktet që nxjerr Qeveria e Kosovës (më poshtë e quajtur: Qeveria), do të përcaktojë rregullat e veprimit të subjekteve që marrin pjesë në biznesin e menaxhimit, përqendrimit, transportit dhe administrimit të mbeturinave në territorin e Komunës. Këto rregulla do të përmbajnë kërkesat teknike dhe kriteret për :

a/ - vendndodhjen ose krijimin e një strukture për mbajtjen dhe hedhjen e mbeturinave,
b/ - lokacionin, klasifikimin, vendosjen dhe transportimin e mbeturinave,
c/ - përpunimin, shfrytëzimin dhe metodat tjera të ripërdorimit të mbeturinave,
d/ - mbledhjen, shkatërrimin ose trajtimin e mbeturinave, dhe
e/ - përdorimin e mbeturinave si material për prodhimin e energjisë, materialeve të papërpunuara, etj.

Neni 11

Drejtoria kompetente nxjerr vendimin për paralajmërime, rekomandime dhe masa mbrojtëse të popullatës në territorin e Komunës në rast të ndotjes, e cila do të tejkalonte nivelet kritike të vlerave të kufizuara për shkarkimin dhe shpërndarjen e materieve ndotëse, përfshirë materialet ndotëse të ngurta, të lëngëta dhe të gazta në ajër, në ujë dhe në tokë.

Neni 12

12.1. Kushdo që ka, ose që mund të ketë dijeni për dëmtim të mjedisit ose aksident ekologjik, për këtë duhet ta njoftojë Drejtorinë kompetente. Institucionet publike të Komunës do të bashkëpunojnë me inspektorët e mjedisit në kërkimin e arsyes për dëmet specifike në mjedis në territorin e komunës.

12.2. Policia dhe zyrtarët tjerë publikë të autorizuar, të cilët gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare vijnë në dijeni lidhur me aksidentet ekologjike ose çrregullim tjetër mjedisor në territorin e Komunës, duhet t'i njoftojnë menjëherë inspektorët komunal të mjedisit.

12.3. Institucionet administrative të Komunës do të bashkëpunojnë me ato të Kosovës dhe do t'i ndihmojnë inspektorët komunal të mjedisit në gjetjen e shkaqeve të çrregullimeve në mjedis dhe të përgjegjësit për çrregullime.

Neni 13

13.1. Personat juridik ose fizik mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

a/ T'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje Ligjit për mbrojtjen e mjedisit;

b/ Të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat lidhur me aktivitetet e tij;

c/ Nëse burimi natyror është pronë publike, dhënia në shfrytëzim e burimit natyror bëhet në përputhje me ligjet në fuqi;

d/ T'i zvogëlojë çrregullimet në mjedis, që rrjedhin prej tij, gjatë zhvillimit të aktivitetit;

e/ Të rehabilitojë ose të rikthejë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit, pas ndërprerjes së veprimtarisë.

13.2. Për projekte të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, projekti i rehabilitimit duhet të përfshihet në raportin e ndikimit në mjedis.

Neni 14

14.1. Kur mund të dëshmohet për neglizhencën, aktet e paramenduara apo shkeljet nga ana e një personi, ndërmarrjeje apo organi publik në territorin e Komunës që sjell një dëm apo aksident në mjedis, personi, ndërmarrja apo organi publik do të detyrohet ta kthejë pjesën e dëmtuar në gjendje që nuk paraqet rrezik për shëndetin publik, apo në gjendje të përgjithshme regjeneruese të pjesës së dëmtuar.

14.2. Në rast se një person, ndërmarrje ose organ publik në territorin e Komunës merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjellë dëm ose aksident në mjedis, personit, ndërmarrjes apo organit publik do t'i kërkohet të ndërmarrë masa të arsyeshme, me të cilat do të sigurojë se aktivitetet e tilla në të ardhmen të bëhen në mënyrë që të:

a/ - zvogëlohet shkarkimi dhe shpërndarja në nivelin e lejueshëm, dhe

b/ - minimizohet rreziku për një aksident në mjedis.

14.3. Nëse pala përgjegjëse për dëmin ndaj mjedisit nuk mund të gjendet, ose në rastet kur personi apo ndërmarrja nuk kanë fonde të mjaftueshme të rregullojnë dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit dhe në rastet kur dëmi i shkaktuar paraqet rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik, Komuna mund të hartojë dhe të implementojë një program të arsyeshëm për rregullimin e dëmit. Në çdo kohë, në fillim apo gjatë programit të tillë, në rast se pala përgjegjëse zbulohet, Komuna mund të rimarrë shumën e shpenzuar për rregullimin e dëmit të bërë nga pakujdesi, akti me paramendim apo nga shkelja e palës.

Neni 15

15.1. Personi, ndërmarrja apo organi publik që planifikon të ndërtojë një objekt industrial, të përpunimit, e në qoftë se një projekt i tillë ka potencial të sjellë dëm për mjedisin, do të bëjë vlerësimin e ndikimit në mjedis (më poshtë i quajtur:VNM).

15.2. Personi, ndërmarrja apo organi publik që planifikon të modifikojë operimin e një objekti industrial apo për përpunim, në rast se kjo paraqet një rrezik potencial për të rritur apo zmadhuar shkarkimin ose shpërndarjen e dëmit ndaj mjedisit, duhet të bëjë VNM-në.

15.3. VNM-ja nuk do të kërkohet në rast të ndërtimit apo modifikimit të ndërtesave rezidenciale, komerciale jo-industriale brenda rajoneve të parapara për ndërtim të tillë me planin hapësinor në fuqi.

Neni 16

Vlerësimi i ndikimit në mjedis do të bëhet në përputhje me aktin e veçantë, të cilin e nxjerr Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (më poshtë e quajtur: Ministria).

Neni 17

Të gjithë nëpunësit civilë që kanë kompetenca për të lëshuar leje ndërtimi, të gjithë personat apo ndërmarrjet që mbajnë leje për të filluar aktivitetet e ndërtimit, janë të detyruar t'i nënshtrohen trajnimit bazik për VNM-në, në bazë të kërkesave nga neni **20 i Ligjit dhe në bazë të akteve plotësuese normative që nxjerr Qeveria.**

Neni-18

18.1. Personat juridik ose fizik mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

- a). Projektet të cilat i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), në përputhje me nenin 9 pika 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe nenit 7 të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis nr.03/L-24 dhe shtojcave të këtij ligji, projekti i rehabilitimit duhet të përfshihet në raportin VNM.
- b). të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat lidhur me aktivitetet e tij;
- c). nëse burimi natyror është pronë publike, të ketë koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër adekuate për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve në përputhje me ligjin;
- d). gjatë aktivitetit të zvogëlojë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij dhe
- e). pas ndërprerjes së veprimtarisë, të rehabilitojë ose rikthejë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit.

Neni-19

19.1-Asnjë institucion nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

19.2-Pëlqimin nga paragrafi 1. të këtij neni e jep Komuna dhe Ministria.

Neni- 20

20.1-Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të cilat duhet të parandaloj ndotjen e mjedisit.

20.2-Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar,

Neni-21

21.1 Vlerat e mbrojtura të natyrës përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

21.2 Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

21.3 Zonat me vlera të veçanta natyrore, me interes për Komunën, gëzojnë mbrojtje të veçante me ligj dhe aktet të tjera të nxjerra në pajtim me ligjin.

21.4 Mbrojtja dhe ruajtja e tërësishme e natyrës në territorin e Komunës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave natyrore, kategorizimi i zonave me vlera të veçanta, procedura e vënies nën mbrojtje, mbrojtja e llojeve të rralla e të rrezikuara të florës dhe faunës, regjimi i mbrojtjes sipas shkallës së kategorizimit, mënyra e menaxhimit të tyre, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje mbi natyrën si dhe mbikëqyrja profesionale e zonave me vlera të veçanta të natyrës bëhet në bazë të dispozitave të veçanta ligjore.

Neni-22

22.1 Me planet hapësinore dhe urbane përcaktohen zonat e ndërtimit në lokacionet e caktuara, varësisht nga kapaciteti i pranueshëm i ndotjes së mjedisit dhe qëllimeve të ndërtimit.

22.2 Në zonat e mbrojtura lejohet kryerja e aktiviteteve në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e veçanta, në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit.

Neni -23

23.1 Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në planet hapësinore, urbane dhe rurale, ndërtohen dhe mirëmbahen në mënyrën e cila mundëson ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.

23.2 Nëse për shkak të ndërtimit të objektit, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe maseve të përcaktuara me PZHUK dhe PRRK. të përcaktuara nga komuna.

23.3 Drejtoria Kompetente harton planin për ruajtjen dhe gjelbërimin e sipërfaqeve publike të gjelbëruar me qëllim të ruajtjes dhe avancimit të vlerave natyrore.

Neni- 24

Subjektet të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit janë të obliguar që, me masa tekniko-teknologjike dhe masat tjera, të sigurojnë që shkarkimet dhe shpërndarjet në ajër të jenë në kufijtë e vlerave të përkufizuara dhe përcaktuara me Ligj dhe aktet tjera nënligjore.

Neni-25

25.1 Në përputhje me aktet e veçanta normative të Qeverisë, dhe me mundësitë e Komunës që të përballojë këto nivele, do të themelohen nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve të ujit.

25.2 Duke respektuar standardet dhe rregullat mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:

a) shkarkimi në ujëra i materieve kontaminuese, të ngurta, të lëngëta ose të gazta, organizmave të gjalla duke përfshirë edhe organizmat e modifikuara gjenetikisht dhe formave të energjisë që shkaktojnë ndryshimin e kthjelltësisë, dekantimit, shtresimit dhe aromës ose ndryshime tjera në cilësinë e ujit;

b) shkarkimi në sistemet publike të kanalizimit, të ujërave të ndotura, të cilat përmbajnë substancat mbi vlerat e përkufizuara ose materialet të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë probleme në sistemin e kanalizimit ose objekteve për pastrimin e ujit;

c) përdorimi i puseve të braktitura si gropa septike për ujëra të ndotura.

Neni-26

Personat juridik dhe fizik të cilët me aktivitetet e tyre në territorin e Komunës bëjnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, grumbullimin e mbeturinave, hirit, ngjyrës ose materialeve tjera, ose shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit, duhet të riformojnë shtresën sipërfaqësore të tokës, rivendosin regjimin e mëparshëm ujqor dhe stabilitetin gjeo-mekanik të tokës gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve.

Neni-27

Drejtoria kompetente, në përputhje me dispozitat e nxjerra nga Ministria, ndërmer masa për mbrojtjen nga zhurma, cakton zonat e vendbanimeve, zonat për pushim dhe rekreacion si dhe bën matjet sistematike të zhurmës dhe vibrimeve.

Neni -28

Personi juridik ose fizik i cili administron me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që të ndërmer të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë për të minimizuar rrezikun për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Neni - 29

30.1 Për rastet e aksidenteve të mundshme ekologjike ose rastet e rrezikimeve të jashtëzakonshme të mjedisit, rrezikimit të shëndetit dhe jetës së njerëzve në territorin e komunës, Kryetari i Komunës, me propozim të Drejtorisë (ve) kompetente nxjerr planet e intervenimit.

30.2. Planet e intervenimit, nga paragrafi 1 i këtij neni, përmbajnë:

- a/ - llojet e rrezikshmërisë si pasojë e aksidentit ekologjik;
- b/ - procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta të dëmshme për mjedis;
- c/ - organet për zbatimin e masave të caktuara; dhe,
- d/ - përgjegjësitë dhe autorizimet lidhur me zbatimin e masave.

Neni 30

Drejtoria kompetente mban regjistrin me të dhëna për mbrojtjen e mjedisit, e të cilat përfshijnë edhe:

- a/ - të gjitha subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuar dhe veprimtaritë e tyre,
- b/ - kërkesat për miratim, licencat dhe autorizime të tjera të tilla që kërkohen e jepen dhe çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me to,
- c/ - çfarëdo informacioni tjetër të marrë ose të siguruar sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, apo akteve tjera normative,
- d/ - hollësi për gjoba, të vendosura sipas ligjit dhe akteve tjera normative.

Neni 31

Mbikëqyrjen inspektive të zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e çrregullimeve të mjedisit në territorin e Komunës, ndikimi i të cilave nuk kalon kufijtë e Komunës, dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen dhe parandalohen nga organet

komunale, e bën inspektori komunal për mjedis në përputhje me aktin e veçantë të Qeverisë.

Neni 32

32.1 Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektive, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, inspektori i mjedisit nxjerr vendim.

32.2 Kundër vendimit të inspektorit komunal për mjedis, ankesa i drejtohet drejtorisë përkatëse.

Neni 33

Me gjobë prej 2.500 deri në 10.000 € për shkelje ekonomike do të dënohet personi fizik ose juridik nëse:

a/ - shfrytëzon burimet natyrore pa leje për shfrytëzim (neni 13),

b/ - fillon realizimin e projektit pa hartimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pa pëlqimin e organit kompetent (neni 15),

c/ - nuk ndërmerr masa sanimi me shpenzime të veta (neni 14),

d/ - kryen veprimtari në të mirat natyrore me rëndësi të veçantë, me të cilat rrezikohet kapaciteti i mjedisit, ekuilibri natyror apo vlerat natyrore e kulturore (neni 21),

e/ - largon dhe hedh mbeturinat dhe materiet e rrezikshme në mjedis jashtë lokacioneve të destinuara për këtë (neni 10).

Neni 34

Me gjobë prej 500 deri në 5.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi fizik ose juridik nëse:

a/ - vepron në kundërshtim me dispozitën e nenit 20 të Rregullores,

b/ - pengon inspektorin komunal në kryerjen e obligimeve nga neni 31 i Rregullores.

Neni 35

Me gjobë prej 100 deri në 300 € do të dënohet për kundërvajtje personi përgjegjës në organin e administratës, përkatësisht në organizatën e cila kryen shërbime publike, nëse nuk informon opinionin dhe nuk nxjerr aktin e fuqizimit të masave në rastet nga neni 11 i Rregullores.

Neni 36

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mamushës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

Nr. _____, më _____